



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.96/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtarin ligjor Albert Haliti, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit, të paditësit N.T.P. “B...P...” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi Avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike - anulim vendimi, objekt kontesti – Klasifikim Tarifor, vlerë kontesti 3,619.20 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor – Publik, të mbajtur, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Avokat Kushtrim Bytyqi, pronarit personalisht B.A., e në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur B.S., me datë 14.02.2023 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit N.T.P. “B...P...” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi Avokat në Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. Mbetet në fuqi Aktvendimi nr. 07.3/1841/2015, i datës 07.08.2020 i Doganës së Kosovës në Prishtinë
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës

A R S Y E T I M

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 07.09.2020, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër Aktvendimit nr. 07.3/1841/2015, të datës 07.08.2020, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e padisë si të bazuar, të anulohet aktvendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë nr. nr. 07.3/1841/2015, i datës 07.08.2020 dhe të detyrohet e paditura t’ia kthej

paditësit mjetet e paguara në bazë të Aktvendimit nr. 05.1/358 datë 21.11.2014 në vlerë prej 3,619.20 euro me kamatë ligjore nga data e pagesës e deri në pagesën e plotë, në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. Përfaqësuesi i palës paditëse si në padi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 16.12.2022 ka deklaruar se : Paditësi me rastin e deklarimit për doganim të mallit doganor në baze të deklaratave doganore kontestuese, numrin tarifor të tyre e ka deklaruar në kreun 3403 siç ishte evidentuar edhe në faturat përkatëse të mallit që i janë bashkangjitur deklaratave doganore. E paditura ka kontestuar numrin tarifor të këtyre mallrave duke vendosur atë nga kreu 2710 duke u mbështetur në mendimin tarifor numër 79 dt:23.06.2014 i cili mendim tarifor është nxjerr lidhur me njërin nga DUD-at kontestues dhe atë për DUD-in R-2566/21.03.2014. Ndërsa, lidhur me DUD- at R-8/02.01.2013 dhe R-19243/18.11.2013 nuk ka nxjerrë mendime tarifore të veçanta. Paditësi kundër vendimit të Doganës së Kosovës nr.07.3/1841 i dt:12.02.2015 ka iniciuar procedurë të Konfliktit Administrativ me c ‘rast gjykata me anë të aktgjykimit A.nr.552/15 i dt:07.03.2019 ka anuluar aktvendimin e atakuar dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim të e paditura me rekomandimin që të nxjerrët mendim tarifor dhe të verifikohen dokumentet e prezantuara nga paditësi. E paditura nuk ka vepruar në këtë mënyrë përkatësisht nuk ka verifikuar vërtetësinë e dokumenteve të deklaruar nga paditësi dhe nuk ka nxjerrë mendime tarifore lidhur me DUD at kontestues siç u theksuar me larte, mirëpo vetëm me anë të e-mail-it i është drejtuar SRV se qëndron mbrapa mendimit tarifor nr.79. Pata dhënies së kësaj përgjigje me anë të e-mail-it sektori i tarifës ka kërkuar nga paditësi që të dërgojë dokumentin me karakteristikat e mallit të quajtur MSDS, ashtu edhe ka vepruar paditësi dhe me anë të e-mailit i ka dërguar dokumentin e theksuar i cili ka numër R0517092 version 1.0 i dt:14.05.2019, mirëpo sektori i tarifës nuk ka marrë për bazë këtë dokument dhe përsëri ka mbetur pranë mendimit tarifor nr.79 duke u referuar me një dokument të titulluar MSDS me numrin e njëjtë sikurse më sipër mirëpo i verzionit 2.0 megjithëse bëhet fjalë për dokument që ka datë më të hershme përkatësisht atë: 12.04.2013. Lidhur më këtë dokument paditësi ka kërkuar në web-fqen e prodhuesit Valvoline mirëpo i njëjti nuk është gjetur me të dhënat i cili i përmban, përkatësisht, verzioni i dt:14.05.2019 ka numër të njëjtë reference dhe për produktin e njëjtë, mirëpo ndryshojnë karakteristikat e mallit. Prandaj, konsiderojmë se një dokument i tillë nuk është autentik përkatësisht nuk është i konfirmuar e as i vërtetuar sepse sipas kërkimit të paditësit në web-faqen e prodhuesi edhe dje dokumenti MSDS me numër të

njëjtë te referencës ka shënime të njëjta sikurse ai i dt:14.05.2019 dhe përsëri ka verzionin 1.0. Duke pasur parasysh këtë fakt, dhe atë se lidhur me këtë lëndë është nxjerrë vetëm një mendim tarifor propozojmë gjykatës që të thirret për dëgjim në cilësinë e dëshmitarit zyrtari doganor hartues i mendimit tarifor z.E.G., i cili kishte me i sqaruar gjykatës se ku e ka mbështetur mendimin tarifor, burimin e informatave, më tutje është më interes të sqarohet edhe arsyeja pse nuk është marrë për baze dokumenti MSDS i dërguar nga paditësi në sektorin e tarifës sipas krekës së tyre, e i cili version mund të gjendet në web-faqen zyrtare të prodhuesit Valvoline. Lidhur me propozimin e parashtruar me padi për nxjerrjen e provës me ekspertize gjyqësore nga fusha e tarifës ne baze të informatave që kemi një ekspert i tillë nuk gjendet ne listën e gjykatës prandaj heqim dore nga një propozim i tillë. Ndërsa në seancën e datës 14.02.2023 ka deklaruar se Mbes në tërësi si në të theksuarat në padi dhe nga seancat e kaluar dhe i propozojmë gjykatës që të vazhdojmë me dëgjimin e dëshmitarit. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 26.07.2021 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi është marrë në bazë të dispozitave ligjore që janë në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, se vendimi i kontestuar është marrë komfor legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 16.12.2022 deklaroi se : Nuk qëndrojnë pretendimet e palës paditëse se vendimi është marrë me shkelje ligjore sepse aktvendimi është nxjerrë në bazë të dispozitave ligjore ne fuqi, i cili konsiderohet si vendim i drejtë. Në rastin konkret, është konstatuar se pala paditëse për mallin lëndor kontestues nuk ka deklaruar drejtpërdrejt Kodin Tarifor 34031910 pasi që malli lëndor kontestues është dashur të tarifohet në Kodin Tarifor 2710198110. Deri të ky konstatim është ardhur pasi që nga sektori i tarifës, sektor profesional për tarifim të mallrave është kërkuar që të bëhet klasifikim i drejtë tarifor, i cili sektor për rastin konkret ka nxjerrë mendimin për klasifikim tarifor me nr.79/23.06.2014, i cili është i bazuar në rregullat e përgjithshme nr.1 deri 6 për interpretimin e TARIK-ut 2014 në bazë të shënimeve shpjeguese të seksionit 5 dhe 6 kapitullit 27 dhe 34, shënimeve plotësuese për krerët përkatës, informatave të marra nga dërguesi, informatave nga interneti lidhur me përmbajtjen e produktit, bazuar në barkodet e vendosura ne etiketën e

mallit dhe informatave të tjera relevante. Nuk qëndrojnë pretendimet e palës paditëse se nga e paditura nuk janë marrë për bazë rekomandimet e gjykatës për arsye se gjatë marrjes së aktvendimin në rivendosje janë marrë për bazë të gjitha rekomandimet e gjykatës dhe pretendimet e palës paditëse, ku edhe është kërkuar që të nxjerrët mendim i ri nga sektori i tarifës me dt:10.07.2020 është bërë kërkesë tek ky sektor që të japin një përgjigje për rekomandimet e gjykatës, ku sektori i tarifës me dt:04.08.2020 përmes e-mailit është përgjigjur që qëndron prapa mendimit për klasifikim tarifor nr.79, cili mendim është nxjerrë bazuar në dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës dhe që ky mendim konsiderohet si mendim i drejtë për klasifikim të mallit lëndor. Sa i përket pretendimit të palës paditëse se nuk është marrë për baze dokumentacioni i prezantuar nga pala paditëse nuk qëndron sepse gjatë marrjes së mendimit për klasifikim tarifor të gjitha shkresat i ka poseduar dhe i ka shqyrtuar me kujdes dhe ka ardhur deri të një konstatim se malli nga pala paditëse nuk është deklaruar me Kodin e duhur tarifor. Sa i përket pretendimit tjetër, se për DUD-at tjerë kontestues nuk është nxjerrë mendim tarifor, sektori i tarifës si sektor profesional për tarifim të mallrave, ka nxjerrë mendim për klasifikim tarifor për njërin nga DUD-at kontestues në rastin konkret, e që duhet të merret për baze edhe për DUD-at e tjerë kontestuese ngase kemi të bëjmë me mall të njëjtë. Për më shumë, për rastin konkret se si ka ardhur deri të ky konstatim janë të cekura të gjitha arsyet në vendimin dhe mendimin kontestuese, e po ashtu edhe në e-mailin e dërguar nga sektori i tarifës, ndërsa në seancën e datës 14.02.2023 ka deklaruar se: Mbesim pranë të cekurave në seancat e kaluara dhe i propozojmë gjykatës që të vazhdojmë me dëgjimin e dëshmitarit. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 14.02.2023, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 07.3/1841/2015 i dt:07.08.2020, Aktvendimi nr.07.3/1841 i dt:12.02.2015, Aktvendimi nr.05.1/358 i dt:21.11.2014, Aktvendimi nr.05.2.1/466 i dt:18.06.2013, Aktvendimi nr.01.3.2.2/24824 i dt:31.03.2022; DUD-at: R-8/02.01.2013, R-19243/18.11.2013, R-2566/21.03.2014, R-26045/05.11.2018, R-10438/01.06.2022, R-82663/25.01.2022; Faturat nr.12-940-000021, nr.13-940-000002, nr.14-940-000001, nr.501197275, nr.145/19/2022/503, Tabela, fletë-dërgesë e faturës e dt:27.12.2012; Deklarata e dt:27.07.2020; Dokumenti SDS R0517092 i datës së revizionit 14.05.2019,

Dokumenti MSDS R0517092 i datës së revizionit 12.04.2013, Dokumenti SDS R0517092 i datës së revizionit 01.02.2019, dokumenti SDS R0517092 i datës së revizionit 17.10.2018; Përgjigja në padi e dt:26.07.2021; Ankesa e ushtruar në Doganën e Kosovës 1841/19.12.2014; Mendimi për Klasifikim Tarifor nr.79/23.06.2014; Korrespondenca – e-mail-at dt:04.08.2020, 16.07.2020, 17.07.2020, 22.07.2020, 18.07.2020, 10.07.2020; Kërkesa për mendim tarifor e dt:10.07.2020; Tabela me të dhëna nga laborator L... i datës 15.11.2022; Dokument në të cilin është pasqyruar mënyra e kërkimit dhe shkarkimit nga interneti të dokumentit për sigurinë e të dhënave të produktit për mallin lëndor; Certifikata e regjistrimit të biznesit në ARBK e datës 21.12.2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga DUD-at kontestues të Doganës së Kosovës, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura me datë 21.11.2014, ka nxjerr aktvendimin nr. 05.1/358, me të cilin ka ndryshuar kodet tarifore të deklaruara nga vet pala këtu paditësi dhe e ka obliguar të njëjtin me detyrime shtesë për DUD-at kontestues, R-8/02.01.2013, R-19243/18.11.2013 dhe R-2566/21.03.2014 si në këtë Aktvendim. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, ndaj aktvendimit 05.1/358, e për të cilën ankesë, e paditura me datë 12.02.2015 ka sjell Aktvendimin nr. 07.3/1841, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e këtu paditësit, ka lënë në fuqi Aktvendimin nr. 05.1/358 të datës 21.11.2014, e kundër të cilit akt paditësi me padi, ka iniciuar konfliktin administrativ pranë gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, Divisioni Fiskal, e cila Gjykatë me Aktgjykimin A nr. 552/15 të datës 07.03.2019, lenden e ka kthyer në rishqyrtim-rivendosje tek e paditura. E paditura duke

vepruar sipas këtij aktgjykimi ka sjell Aktvendimin 07.3/1841/2015 të datës 07/08/2020 si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e këtij paditësit, ka lënë në fuqi Aktvendimin nr. 05.1/358 të datës 21.11.2014, e kundër të cilit akt paditësi me këtë padi për herë të dytë, ka iniciuar kontestin tregtar tani pranë kësaj gjykate.

Nga provat shkresore të administruara në këtë kontest tregtar administrativ, del se e paditura Dogana e Kosovës-Sektori i Kontrollit pas Importues duke vepruar sipas detyrës zyrtare, ka iniciuar kontrollin dokumentar ndaj paditësit, nën dyshimin se nuk e ka tarifuar saktë mallin e importuar me DUD-at kontestues. Si rezultat i kësaj e paditura - Sektori i Kontrollit Pas Importues, duke u bazuar edhe në Mendimin për Klasifikimin Tarifor nr. 79/23.06.2020, për mallrat e zhdoganuara nga këtij paditësi me DUD-in kontestues R-2566/21.03.2014, të dhënë nga Sektori i Tarifave, i cili vepron në kuadër të paditurës, ka ardhur në përfundim se paditësi me DUD-at kontestues, me rastin e zhdoganimit të mallit, nuk i ka deklaruar saktë kodet tariforë të mallit, në rubrikën 33, 41 dhe 47, të DUD-ve kontestues, ngase mallin e deklaruar për zhdoganim e ka deklaruar, me numrin-kodin tarifor 3403191000, numër ky i cili e ka liruar mallin nga taksa e akcizës ndërsa sipas Sektorit të Tarifës pranë të paditurës bazuar edhe në Mendim për Klasifikimin Tarifor si më lartë është dashur të tarifohet *në numrin-kodin tarifor 2710198110*, sipas të cilit numër për mallin e deklaruar duhet të paguhet Akciza në vlerë prej 3,120.00€ dhe diferenca e TVSH-së në shumë prej 499.20€, apo gjithsej detyrime doganore prej 3,619.20€.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata vlerëson se nuk qëndron pretendimi i paditësit se e paditura ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për arsye se, nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi as në procedurë administrative tek e paditura, por as në këtë kontest tregtar

administrativ gjykatës nuk i ka paraqitur ndonjë dëshmi apo *“informatën tarifore detyruese nga BE-ja, shteti eksportues dhe/apo prodhues”*, për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar përmes DUD-ve kontestues, mbi bazën e të cilit deklarim paditësi është liruar nga pagesa e taksës doganore prej 10%. Në këtë drejtim, gjykata konstaton se është i pa bazuar pretendimi i paditësit i deklaruar në padi sipas të cilit numri tarifor i mallit lëndor të ndryshuar nga Dogana nuk i përgjigjen rastin konkret, sepse Sektori i Rishqyrtimeve pranë të paditurës është thirr në mendimin për klasifikim tarifor të lëshuar për këtu paditësin, nr. 79 të datës 23.06.2014, e të ri-konfirmuar nga Sektori i tarifës edhe me e-mailin e datës 04.08.2020.

Gjykata duke i pasur parasysh dispozitat ligjore të nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, konstaton se në rastin konkret nuk kemi as shkelje esenciale të dispozitave të KDA-së, ngase në dispozitën e nenit 123 të UA si më lartë, shprehimisht parashihen dokumentet që duhet bashkangjitur deklaratës doganore e ku në mes tjerash në paragrafin 1 pika C thuhet; *“Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruar”*, konstaton se ka qenë obligim i paditësit që në procedurë administrative tek e paditura të ofrojë prova konkrete për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar, respektivisht informatën tarifore detyruese nga BE-ja apo autoriteti doganor i shtetit eksportues, për vendosje të mallit lëndor në qarkullim të lirë, gjë të cilën nga shkresat e lëndës rezulton që paditësi nuk e ka bërë.

Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se paditësi nuk ka ofruar provat relevante gjegjësisht informatën detyruese tarifore nga vendi eksportues dhe i origjinës së mallit, sqarime nga prodhuesi, për Deklaratat Doganore kontestuese, për të vërtetuar pretendimin se vërtet malli lëndor klasifikohet në kodin tarifore siç janë deklaruar nga paditësi dhe jo ashtu siç janë ndryshuar nga e paditura me aktvendimin kontestues. Gjykata nga dispozita e nenit 24 të KDA-së, ku thuhet se : *“Detyrimet e importit për t’u paguar ligjshëmrisht kur lind një borxh doganor, bazohen në nomenklaturën e mallrave të TARIK-ut, Tarifës Doganore të Kosovës, ligjeve të zbatueshme në Kosovë dhe çdo marrëveshje me një vend tjetër apo grup vendesh, ku hyn edhe Kosova kur merren masa për lejimin e trajtimit preferencial*

tarifor”, përcakton aplikimin e TARIK-ut në Kosovës, gjithmonë përderisa nuk kemi informatë tarifore detyruese për mallin konkret nga BE-ja, apo autoriteti doganor i shtetit eksportues të mallit.

Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit kontestuese, për arsye se, e paditura Dogana e Kosovës pas marrjes të Mendimeve për Klasifikim Tarifor nga Sektori i Tarifës si sektor i specializuar i cili vepron në kuadër të paditurës, me të drejtë ka konstatuar se në rastin konkret malli lëndor është dashur të tarifohet varësisht sipas përshkrimeve dhe atë : *në numrin-kodin tarifor 2710198110* sipas të cilave kode për mallin e deklaruar duhet të paguhet taksa e akcizës prej 2,120.00 euro, dhe diferenca e TVSH-së në vlerë 499.20 euro, e jo të deklarohen në numrin-kodin tarifor 3403191000, numër ky i cili e ka liruar mallin nga taksa e akcizës. Deri tek ky përfundim e paditura ka ardhur duke u bazuar në rregullat e përgjithshme numër 1-6 për interpretimin e TARIK-2014, e në bazë të shënimeve shpjeguese të seksionit V dhe IV, kapitullit 27 dhe 34, shpjegimeve plotësuese për krerët përkatës, informatave të marra nga importuesi, informatave nga interneti lidhur me përmbajtjen e produktit bazuar në bar kodin e vendosur në etiketën e mallit si dhe informatave tjera relevante.

Sipas nenit 24 par.1 të KDA-së është paraparë që *“Detyrimet e importit për t’u paguar ligjshëmrisht kur lind një borxh doganor, bazohen në nomenklaturën e mallrave të TARIK-ut, Tarifës Doganore të Kosovës, ligjeve të zbatueshme në Kosovë dhe çdo marrëveshje me një vend tjetër apo grup vendesh, ku hyn edhe Kosova kur merren masa për lejimin e trajtimit preferencial tarifor”*. Tutje Kontrollimi i deklaratave pas zhdoganimit, mund të bëhet bazuar në nenin 82, par 1. të KDA-së, *“Dogana sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të deklaruesit e rishqyrton deklaratën pas lirimt të mallit. 2. Dogana, pasi ta ketë lejuar lirimt e mallrave dhe më qëllim që të sigurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara, në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky kontroll mund të kryhet në ambientet e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij ose të çdo personi tjetër në posedimin e të cilit janë dokumentet e lartshënuara për qëllime tregtie. Dogana,*

po ashtu mund të kontrollojë edhe mallrat kur paraqitja e tyre është ende e mundur. 3. Pa rënë ndesh me nenin 219.3 kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana, në përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmerret masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion”. Rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur paditësin e ka obliguar me detyrime doganore shtesë për shkak të deklaramit të pa saktë të kodit tarifor për mallin e zhdoganuar përmes DUD-ve kontestues.

Gjykata sipas propozimit të palës paditëse ka dëgjuar E.G. dhe F.M.në cilësi të dëshmitarëve si dhe B.A., pronarin në cilësi të palës.

Gjykata nga dëshmitë e dëshmitarit E.G. vërtetohet se i njëjti ishte udhëheqësi i sektorit të tarifës në kohën kur është lëshuar mendimi mbi klasifikimin tarifor 79/23.06.2014, dhe i njëjti ishte edhe autor i atij mendimi tarifor, tutje dëshmitari deklaron se për mendimin tarifor në fjalë të cilin e kemi lëshuar, unë qëndroj mbrapa atij mendimi duke u bazuar në të dhënat të cilat na janë ofruar nga Sektori i Auditimit të Jashtëm të Doganës së Kosovës.

Gjykata nga dëshmitë e dëshmitarit Fetah Mehmeti vërtetohet se i njëjti ishte në sektorin të tarifës në kohën kur është lëshuar e-maili i datës 04.08.2020, dhe i njëjti ishte edhe autor i atij ri-konfirmimit të mendimit tarifor paraprak të datës 23.06.2014, tutje dëshmitari deklaron se kërkesa kur ka ardhur nga sektori i Rishqyrtimeve ka qenë se a mbeteni pranë mendimit tarifor të lëshuar më herët lidhur me këtë rast. Në bazë të dokumenteve fizike në lëndë kemi kthyer përgjigje se mbetemi pranë mendimit për klasifikim tarifor të lëshuar më herët lidhur me këtë rast. Diçka tjetër nuk kam për të shtuar, përveç se e njoftoj gjykatën se kur është lëshuar mendimi i parë për klasifikim tarifor, unë nuk kam qenë pjesë e sektorit të tarifës, ndërsa siç e theksova më lartë kur është ri-konfirmuar mendimi për klasifikim tarifor kur kam qenë pjesë e sektorit të tarifës.

Gjykata nga dëgjimi i B.A. në cilësi të palës nuk mundi të vërtetoj gjendje tjetër faktike përveç ri-përsëritjes së pretendimeve të cekura në padi dhe gjatë seancave gjyqësore.

Si përfundim, Gjykata konsideron se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt. Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë nr. 07.3/1841/2015 i datës 07.08.2020, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Në sa u përshtrua, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par.1 dhe 2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.96/22 datë 14.02.2023

Zyrtari Ligjor
Albert HALITI

Gj y q t a r i
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.